



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/45


Datë: 21.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 gusht 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Statusin dhe të Drejtat e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/45

Datë: 21.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 gusht 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Mjekësinë Ligjore.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/45

Datë: 21.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 gusht 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë me Bankën Botërore për Projektin e Përmirësimit të Sistemi të Arsimit në Kosovë

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për dhënien e autorizimit për Ministrin e Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë me Bankën Botërore për Projektin e Përmirësimit të Sistemi të Arsimit në Kosovë.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/45

Datë: 21.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 gusht 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes dypalëshe për heqjen e ndërsjellë të vizave hyrëse për bartësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme që të zhvilloj negociata me Shtetin e Kuvajtit me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/45

Datë: 21.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 gusht 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Këshillit Kombëtar për Ndryshime Klimatike

Neni 1

Qëllimi i Vendimit

Qëllimi i këtij vendimi është themelimi i Këshillit Kombëtar për Ndryshime Klimatike në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës (këtu e tutje të referuar në këtë Vendim si "Këshilli").

Këshilli ka përgjegjësinë për përcjelljen e zbatimit të dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit për ndryshimet klimatike në përputhje me angazhimet në kuadrin e UNFCCC dhe Protokollit të Kiotos.

Neni 2

Funksionet e Këshillit

Këshilli kryen funksionet e mëposhtme:

1. Koordinon aktivitetet për zbatimin e angazhimeve në kuadrin e UNFCCC dhe Protokollit të Kiotos;
2. Siguron që projektet që mund të kenë ndikim në ndryshimet klimatike të realizohen në përputhje me legjislacionin vendor dhe marrëveshjet ndërkombëtare;
3. Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin në konventa, protokolle, marrëveshje që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, dhe
4. Bënë përgatitjen e Komunikimit Kombëtar për Sekretariatit e Konventës UNFCCC pas ratifikimit të Protokollit të Kiotos.

Neni 3

Përbërja e Këshillit

1. Këshilli ka përbërjen si vijon:

- 1.1. Kryetar: - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

1.2. Ministrat e mëposhtëm janë anëtarë:

- Ministri i Zhvillimit Ekonomik;
- Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministri i Infrastrukturës;
- Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministri i Integritimit Evropian dhe
- Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal;

2. Sekretariati Teknik i Këshillit ka përbërjen si vijon:

2.1. Kryesues: Drejtori i Mbrojtjes së Mjedisit.

2.2. Përfaqësuesit e mëposhtëm janë anëtarë:

- Drejtori i Ujërave;
- Drejtori i Energjisë;
- Drejtori i Infrastrukturës Rrugore;
- Drejtori i Industrisë;
- Drejtori i Pylltarisë;
- Drejtori i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Drejtori i Politikave Sektoriale;
- Drejtori i Institutit Hidrometeorologjik;
- Një përfaqësues nga shoqëria civile;
- Një përfaqësues nga Universiteti dhe
- Një përfaqësues nga UNDP.

2.3. Përgatitja e punimeve të Këshillit kryhet nga Sekretariati Teknik.

**Neni 4
Zbatimi i Vendimit**

Përgjegjës për zbatimin e vendimit janë institucionet nga neni 3.

**Neni 5
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAJA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë